



RELACION PROJEKTVENDIMI

PËR

DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 01, DATË 05.12.2020, **“PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR NGRITJEN, CAKTIMIN DHE NJOFTIMIN E** **VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT DHE PËRGATITJEN E HARTËS SË** **NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE PËR ZGJEDHJET”, I NDRYSHUAR**

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Referuar nenit 20 pika 1, shkronja “a”, të Kodit Zgjedhor, parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektakte me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Qëllimi i udhëzimit nr.01, datë 05.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, i ndryshuar është të përcaktojë rregullat për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10019, datë 29.12.008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga përvoja e deritanishme rezulton se ndryshimet e vendndodhjeve të qendrave të votimit (QV) përgjatë proceseve zgjedhore janë diktuar jo nga arsye të forcave madhore.

Për zgjedhjet e datës 14 maj 2023:

- KQZ shqyrtoi dhe miratoi vendosjen e 333 QV-ve në ndërtesa private bazuar në propozimet e kryetarëve të bashkive.
- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pas afatit 40-ditor, autorizoi ndryshimin e vendndodhjes së 39 QV-ve në ambiente private për arsye madhore.
- Në total, nga 5,213 QV, 333 prej tyre u vendosën në objekte private.

Për zgjedhjet pararendëse për Kuvend të vitit 2021:

- U miratua ndryshimi i vendndodhjeve për 105 QV në ambiente private kryesisht në Bashkitë Tiranë (67 raste) dhe Durrës (32 raste).
- Në total, 389 QV u vendosën në ndërtesa private.

Ndryshimet e vendndodhjeve shpesh ndodhën për shkak të problematikave si mungesa e energjisë elektrike, dëmtime nga tërmeti i vitit 2019, konstatimi me vonesë nga bashkitë të problematikave funksionale të ambienteve.

Gjithashtu është konstatuar se bashkitë kanë ndryshuar në mënyrë të paargumentuar vendndodhjet e qendrave të votimit para periudhës 40 ditë para datës së zgjedhjeve.

Në vitin 2023 për shkak të mos rakordimit të të dhënave në sistemet e informacionit nga njësitë e organeve të vetëqeverisjes vendore me DPGJC dhe me KQZ rezultojnë rreth 270 qendra votimi me

adresa që nuk përputhen me gjendjen reale duke krijuar shqetësime jo vetëm tek zgjedhësit por edhe tek administrata e KQZ-së për të referuar vendndodhjen e saktë të tyre.

Ndonëse në disa raste ndërhyrjet u kryen për të siguruar akses më të mirë për zgjedhësit, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, duhet nënvizuar se ky aspekt i ndryshimit të vendndodhjeve të qendrave të votimit mbetet një sfidë që kërkon vëmendje të vazhdueshme.

Gjithashtu një problematikë e konstatuar në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Himarë më 4 Gusht 2024, u evidentuan raste të mos identifikimit të përshtatshëm/ duhur nga bashkitë për vendndodhjet qendrave të votimit dhe infrastrukturës së tyre.

Këto situata evidentuan nevojën për ndërhyrje në udhëzimin nr. 1/2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, me qëllim vendosjen e kritereve objektive për kryetarët e organeve të vetëqeverisjes vendore dhe mekanizmin objektiv të ndërhyrjes së KQZ për rastet kur nga organet vetëqeverisjes vendore nuk respektohen kriteret e përcaktuara në nenet 62 dhe 93 të Kodit Zgjedhor.

Neni 62 pika 4, përcakton qartë se “Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive apo të parashikuara në nenin 93, kjo nuk është e mundur.” Referuar kësaj dispozite Vendndodhja e qendrave të votimit është një element thelbësor i procesit zgjedhor, dhe ndryshimi i saj i pamotivuar mund të cenojë besimin e zgjedhësve në proces. Ndaj vendosja e kritereve të qarta synon të sigurojë që ndryshimet e vendndodhjes bëhen vetëm kur ka arsye të forta dhe të justifikuara, duke përjashtuar çdo mundësi për cenim të këtij standardi.

Projekt vendimi synon që të vendosen kritere për kryetarët e organeve të vetëqeverisjes vendore në mënyrë që bashkitë të mos ndryshojnë vendndodhjen e qendrave të votimit në mënyrë arbitrare apo për motive të paarsyeshme, të cilat mund të krijojnë konfuzion tek zgjedhësit ose t'i penalizojë ata që nuk mund të përshtaten me ndryshimet. Vendosja e kritereve synon të ndihmojë në shmangien e vendimeve të paarsyetuara dhe të ruajë qëndrueshmërinë e vendndodhjeve të qendrave të votimit.

Projektvendimi i propozuar për miratim përmban disa shtesa dhe ndryshime të udhëzimit në fuqi. Në këtë projekt vendim parashikohet riformulimi i nenit 9 . Në paragrafin e parë përcaktohet se Kryetarët e bashkive mund të ndryshojnë vendndodhjen e QV-ve deri në 41 ditë para zgjedhjeve për arsye objektive dhe duhet të arsyetojnë e dokumentojnë këto ndryshime.

Ky përcaktim siguron që vendimet për ndryshimin e QV-ve të jenë të bazuara në kushte objektive dhe të justifikuara, duke parandaluar vendime arbitrare apo të paarsyetuara që cenojnë standardin. Krahasimi i vendndodhjes ekzistuese dhe të re ndihmon në zgjedhjen e një vendi më të përshtatshëm për zgjedhësit.

Pika 2 parashikon që kryetari i bashkisë të sjellë në KQZ një kopje të vendimit së bashku me relacionin i cili duhet të përfshijë të dhëna specifike për vendndodhjen e re dhe arsyet e ndryshimit.

Këto kërkesa për të dhëna të detajuara dhe arsyetim të qartë rrisin transparencën dhe besueshmërinë e procesit, duke garantuar se ndryshimet janë të justifikuara për të gjitha palët në proces, për administratën e KQZ-së që do të monitorojë këtë veprimtari por edhe për partitë politike. Nëpërmjet këtij mekanizmi synohet që distanca dhe lidhja gjeografike me zgjedhësit të sigurojnë që zgjedhësit të mos dëmtohen nga ndryshimi i vendndodhjes.

Në pikën 3 përpos transpozimit të nenit 62, sipas të cilit ndryshimet në 40 ditët e fundit lejohen vetëm për arsye madhore dhe me autorizim nga KQZ, kjo pikë vendos kufizime për ndryshimet në periudhën kritike përpara zgjedhjeve, duke garantuar stabilitet dhe shmangur konfuzionin e zgjedhësve. Me

qellim përdorimin me kriter te arsyetimit për forcë madhore janë sqaruar rastet te cilat përbëjnë force madhore ne mënyrë që vetëm emergjencat të justifikojnë ndryshime në këtë fazë. Madje me qellim zbatimin e duhur te kësaj dispozite është përcaktuar qe autorizimi kërkohet për te gjitha llojet e objekteve (private, publikë apo te posaçme).

Ne piken 4 deri 6 te projektvendimit është parashikuar mekanizmi për monitorimin dhe hapat qe duhet te ndiqen nga administrata e KQZ-se ne rast se evidentohen kryesisht apo me ankesa mos përmbushje te kritereve ligjore, si dhe gjetjen e ambienteve alternative nga administrata e KQZ-se e cila mund të caktojë vendndodhje alternative në raste problematike.

Kompetenca e Komisionerit për të ndryshuar vendndodhjen e QV-se ne ambiente alternative shmang pengesat në raste urgjente ose në rastet kur pushteti vendor nuk përmbush detyrimet.

Në nenin 10, pika 1, në frymë te zbatimit të nenit 62 dhe 51, është përcaktuar që Kryetarët e bashkive të raportojnë në KQZ numrin, vendndodhjen dhe të dhënat e zgjedhësve të QV-ve sipas udhëzimeve të KQZ-së dhe vetëm në rast ndryshimesh, raportohen vetëm të dhënat e QV-ve që ndryshojnë. Vendosija e afateve të qarta për raportim siguron që KQZ dhe palët e interesuara të kenë informacion të përditësuar dhe të saktë ndërsa raportimi i pjesshëm (vetëm për QV-të që ndryshojnë) redukton burokracinë dhe lehtëson procesin.

Në pikën 3 të këtij neni synohet eliminimi i keqkuptimeve dhe shmangien e mbivendosjeve ose pasaktësitë që mund të ngadalësojnë zbatimin e dispozitave.

Propozimet për ndryshime synojnë rritjen e qartësisë ligjore, sigurimin e një procesi zgjedhor të rregullt dhe përmirësimin e standardeve të aksesueshmërisë dhe transparencës për të gjitha palët e përfshira.

Projektvendimi ju është përcjella për mendim shoqërisë civile dhe partive politike. Instituti i Studimeve Politike ka përcjellë disa rekomandime te cilat u vlerësuan nga administrata e KQZ-se.

1. ISP sugjeron që të përdoret termi "kryetari i bashkisë" dhe të përfshihet dhe "ushtruesi i funksionit të kryetarit të bashkisë", për të mbuluar rastet kur kryetarët janë në gjendje arresti ose dorëhequr.

Termi i përdorur ne projektakt është ne përputhje me përmbajtjen origjinale te tij dhe me termin e përdorur ne Kodin Zgjedhor që është akti specifik që rregullon detyrat dhe kompetencat e organeve te vetëqeverisjes vendore në kontekstin e procesit zgjedhor. Ndaj vlerësojmë se emërtimi duhet të përputhet me atë të Kodit Zgjedhor për të siguruar koherencë ligjore.

2. ISP kërkon që, në vend të partive politike, të përfshihen të gjitha subjektet elektorale të regjistruara, përfshirë kandidatët e pavarur. Gjithashtu sugjeron që jo vetëm përfaqësuesit e partive politike, por edhe koalicionet dhe kandidatët e pavarur, të kenë mundësinë e ankimit.

Duke qënë se **neni 62 dhe 93 e Kodit Zgjedhor kanë përcaktuar rolin e partive politike dhe subjekteve zgjedhore ndaj nuk vlerësohet e nevojshme** përsëritja e parimeve të cilat mund të dëmtojë qartësinë në interpretimin e rregullave.

3. ISP kërkon që Kryetar i bashkisë Komisioneri të ketë kompetencën e plotë për caktimin e qendrave të votimit, duke siguruar dakordësinë e bashkive, për të garantuar që ndodhen në vende që përmbushin kriteret ligjore.

Lidhur me këtë kërkesë sqarojmë se bazuar edhe në vendimin 15/2024 të KAS, Komisioneri ka kompetencën për të vendosur ndryshimin e vendndodhjes se qendrave të e votimit në përputhje me kërkesat ligjore. Ndaj parë në këtë këndvështrim bashkitë duhet të mbështesin këtë proces, duke ofruar informacion dhe bashkëpunim. Dakordësia e bashkisë është e rëndësishme, por Komisioneri ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të siguruar se vendndodhja e qendrave të votimit është e përshtatshme dhe në përputhje me ligjin.

4. ISP ka kërkuar që të bëhet një plotësim i dispozitës për ta bërë më funksionale rolin e KQZ-së në rastet kur administrata e KQZ-së vlerëson se vendndodhja e QV nuk është bërë në përputhje me kriteret ligjore. Ky rekomandim është marrë parasysh duke riformuluar pikat 4 deri në 6.

Janë detajuar mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e qendrave të votimit, veprimet në rast të mosplotësimit të kriterëve dhe procesin vendimmarrës të Komisionerit për caktimin e vendndodhjeve alternative që plotësojnë kërkesat ligjore.

Për sa më sipër, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim, projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 01, datë 05.12.2020, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, i ndryshuar.

Erion META – Drejtorja e Administratës Zgjedhore
Pavlina DOÇAJ - Drejtorja e Ligjshmërisë
Majlinda ÇELMETA - Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: .2025

Nr: 00

Ora: 00:00

PROJEKTVENDIM

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIM NR. 01, DATË 05.12.2020,
“PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR NGRITJEN, CAKTIMIN DHE NJOFTIMIN E
VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT DHE PËRGATITJEN E HARTËS SË
NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE PËR ZGJEDHJET”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1, shkronja "a", e 3, nenit 46, pikat 1 dhe 2, nenit 50, pika 3, neneve 52, 62, 93, nenit 108, pika 7 dhe nenit 109, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator,

VENDOSI:

Në Udhëzimin nr. 01, datë 05.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në pikën 3, të nenit 8, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “ose me mjete elektronike” sipas përcaktimeve të Komisionerit”.
2. Neni 9, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 9

Ndryshimi i vendndodhjes së qendrës së votimit

1. Për periudhën deri në 41 ditë para ditës së zgjedhjeve, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore mund të ndryshojë vendndodhjen e qendrës së votimit në ambiente publike vetëm për arsye objektive. Në vendimin e tij, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të arsyetojë dhe dokumentojë shkaqet e ndryshimit duke përfshirë një krahasim të qartë të kushteve të vendndodhjes ekzistuese dhe asaj të re për:

Data: xx.xx.2025 Nr:
Ora: xx:xx



Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzim nr. 01, datë 05.12.2020, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, i ndryshuar

- a. Vlerësimin e kushteve të infrastrukturës dhe aksesueshmërisë së zgjedhësve në ambientin ekzistues dhe atë të ri,
 - b. Vlerësimin e kushteve të sigurisë së vendndodhjeve përkatëse,
 - c. Verifikimin e kapaciteteve të ambienteve për akomodimin e zgjedhësve.
2. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dërgon në KQZ vendimin shoqëruar me relacionin, i cili duhet të përmbajë të dhëna të qarta për statusin e ambientit ekzistues dhe atij të ri (propozuar), duke përfshirë arsyet që diktojnë këtë ndryshim, të tilla si:
- a. Dhënia e sqarimeve nëse vendndodhja e re ndodhet brenda të njëjtit territor kompakt dhe të pashkëputur gjeografik për zonën e QV-së.
 - (i) Nëse vendndodhja e re e QV-së është në një zonë tjetër qendre votimi duhet të specifikojë arsyet për këtë ndryshim dhe nevojën që e dikton këtë ndryshim.
 - b. Distancën (në metra/ km) të vendndodhjes së re nga vendndodhja e mëparshme dhe nga zona ku banojnë zgjedhësit e QV-së,
 - c. Të specifikojë arsyet objektive që çuan në ndryshimin e vendndodhjes, dhe të dokumentojë dhe provojë arsyet që e kanë bërë të pamundur përdorimin e vendndodhjes së mëparshme.
3. Vendndodhja e qendrës së votimit (publik, privat) nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore mund të kërkojë ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit me autorizim nga KQZ-ja vetëm për arsye të forcës madhore. Do të konsiderohen forcë madhore fatkeqësitë natyrore që dëmtojnë ose bëjnë të pamundur përdorimin e qendrave të votimit, problemet e papritura infrastrukturore që pengojnë procesin e votimit apo rrezikojnë sigurinë e votuesve dhe administratës zgjedhore në qendrat e votimit. Kërkesa për autorizimin e ndryshimit të vendndodhjes sipas këtij paragrafi shoqërohet me arsyetimin për plotësimin e kritereve të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni.
4. Administrata e KQZ-së monitoron dhe vlerëson qendrat e votimit për të siguruar që ato përmbushin kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor.
5. Në rastet kur administrata e KQZ konstaton se një qendër votimi ose ndryshimi i propozuar nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenet 62 dhe 93 të Kodit Zgjedhor dhe këtij udhëzimi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për gjetjet dhe kërkon zgjidhje alternative brenda afatit të caktuar prej tij në njoftim. Nëse kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk paraqet propozime alternative, administrata e KQZ-së identifikon ambiente alternative (publike ose private) që plotësojnë standardet dhe përgatit një raport të detajuar për t'ja paraqitur Komisionerit.
6. Komisioneri shqyrton në seancë publike raportin e administratës së KQZ-së dhe vendos për ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit në një ambient alternativ që i plotëson kriteret ligjore. Pas vendimit të KQZ-së, qendra e votimit nuk ndryshon.

3. Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore apo zyrtari që ushtron këtë funksion, menjëherë pas miratimit të listës së zgjedhësve, dërgon në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, DPGJC dhe Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor përkatës, numrin e çdo QV-je, vendndodhjen e tyre, numrin përkatës të zgjedhësve në listën e zgjedhësve, numrin e zgjedhësve me aftësi ndryshe, dhe të dhëna të tjera përfshirë edhe kërkesat e përcaktuara në nenin 6 të këtij udhëzimi me shprehje ose në formë elektronike, sipas udhëzimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në rastin e ndryshimeve të vendndodhjes së qendrave

të votimit deri 41 ditë para ditës së zgjedhjeve dërgon në KQZ, DPGJC dhe në KZAZ, vetëm të dhënat për vendndodhjet që ndryshojnë, jo me vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve. DPGJC duhet të pasqyrojë adresën e përcaktuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Iirjana NANO	Kryetar
Arens ÇELA	Anëtar
Dritan ÇAKA	Anëtar
Helga VUKAJ	Anëtar
Muharrem ÇAKAJ	Anëtar